

RAPORT MBI PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË.



QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

VITI AKADEMIK 2017-2018

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

TIRANË, Nëntor 2017

Përmbajtja

Parathënie.....	3
Shënime për raportin.....	4
Kreu I.....	5
Procesi i Aplikimit dhe Pranimeve në nivel kombëtar	5
Kreu II.....	6
Regjistrimet në nivel sistemi shkollimi (IAL publike/jopublike).....	6
Kreu III.....	7
Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL-je	7
Kreu IV.....	10
Regjistrimet kundrejt kuotave	10
Kreu V.....	15
Raporti kuota – kërkesa nga aplikantët në nivel IAL.....	15
Kreu VI.....	19
Procesi i aplikimeve dhe regjistrimeve në nivel program studimi.....	19
Kreu VII.....	21
Regjistrimet sipas gjinisë dhe urbanizimit	21
Kreu VIII.....	23
Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL	23
Kreu IX.....	28
Cilësia e studentëve të regjistruar sipas gjinisë dhe urbanizimit.....	28
Kreu X.....	29
Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dëndurive në segmentet e notave mesatare	29
Kreu XI	
RAPORT MBI PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË.....	1
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE	1
VITI AKADEMIK 2017-2018	1
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË	1
Parathënie.....	4
Shënime për raportin.....	5
Kreu I.....	6

Procesi i Aplikimit dhe Pranimeve në nivel kombëtar	6
Kreu II	7
Regjistrimet në nivel sistemi shkollimi (IAL publike/jopublike)	7
Kreu III	8
Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL-je	8
Kreu IV	11
Regjistrimet kundrejt kuotave	11
Kreu V	16
Raporti kuota – kërkesa nga aplikantët në nivel IAL.....	16
Kreu VI.....	20
Procesi i aplikimeve dhe regjistrimeve në nivel program studimi	20
Kreu VII.....	22
Regjistrimet sipas gjinisë dhe urbanizimit	22
Kreu VIII.....	24
Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL	24
Kreu IX.....	29
Cilësia e studentëve të regjistruar sipas gjinisë dhe urbanizimit.....	29
Kreu X.....	30
Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dëndurive në segmentet e notave mesatare	30
Kreu XI.....	37
Procesi i pranimit në programet e studimit që mund të profilizohen mësuesi.....	37
Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi	38
Kuota , të regjistruar në nivel IAL programe që mund të profilizohen mësuesi.....	40
Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e mësuesisë.....	44
Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dëndurive në segmentet e notave mesatare	49

Parathënie

Ky raport ka për qëllim, jo vetëm të të pasqyrojë procesin e aplikimeve dhe regjistrimeve në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2017-2018, në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), por edhe të orientojë më qartësisht vendimmarrësit në fushën e arsimit, maturantët dhe kandidatët për studentë gjatë përzgjedhjes së tyre për programet e studimit që ofrohen nga Institucionet e Arsimit të Lartë, IAL-të publike dhe jopublike në hartimin e strategjive më të mira për ndërtimin e kurrikulave dhe programeve të reja të studimeve, për informimin e maturantëve dhe kandidatëve rreth programeve të studimit që ofrojnë dhe si dhe orientimin e tyre në tregun e punës në të ardhmen.

Gjithashtu, synohet një ndërgjegjësim më i mirë i kandidatëve për student, për t'u fokusuar më mirë në ato programe studimi, ku ata mund të arrijnë potencialin e tyre maksimal dhe ku kanë më shumë mundësi të pranohen.

Meqenëse kriteret e pranimit, të vendosura nga IAL-të, mbështeten kryesisht në arritjet e maturantëve dhe kandidatëve në arsimin e mesëm të lartë si dhe duke qenë ky filtri kryesor hyrës në IAL, mund të themi se, tërheqja e studentëve cilësorë në hyrje është një faktor i rëndësishëm që përcakton edhe cilësinë në vijueshmërinë e studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky material jep informacion mbi aplikantët dhe studentët e pranuar në IAL, si edhe nivelin e studentëve hyrës sipas kriterit të notës mesatare. Në të, informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që bën të mundur, jo vetëm njohjen e cilësisë të studentëve të pranuar në nivel kombëtar, por edhe në nivel IAL-je dhe programi studimi.

Shënime për raportin

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e të dhënave e krijuar nga QSHA për:

- Realizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2017.
- Mbledhjen e të dhënave për arsimin e mesëm të lartë nga shkollat dhe përllogaritjen e notës mesatare sipas VKM Nr. 346, date 19.04.2017 për çdo maturant aplikues.
- Kuotat e verifikuara dhe çertifikuara nga Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë për kategorinë shqiptarë brenda vendit.
- Aplikimin deri në dhjetë përzgjedhje të çdo maturanti dhe kandidati për studime në IAL.
- Regjistrimet e studentëve nga sekretaritë mësimore të IAL-ve në portalin U-Albania për vitin akademik 2017-2018 (cikli i parë i studimeve për kategorinë shqiptarë brenda vendit).

Maturantët dhe kandidatët aplikuan në sistemin online të Maturës Shtetërore në dy raunde aplikimi duke përzgjedhur deri në 10 preferenca si dhe kryen regjistrimin në dy raunde pasuese në Portalin U-Albania për pranimet në ciklin e parë të studimeve të vitit akademik 2017-2018.

Vëmë në dukje se në dy vitet e fundit akademike, 2016-2017 dhe 2017-2018, mbështetur në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, u përcaktua si kriter aplikimi e pranimi në Institucionet e Arsimit të Lartë në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, nota mesatare minimale 6. Kjo notë do të përllogaritej si mesatare aritmetike e thjeshtë e dy treguesve:

1. Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit të arsimit të mesëm të lartë
2. Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

Po sipas këtyre vendimeve, për programet e studimit dyvjeçare me karakter profesional, nuk ishte detyrim kriteri i notës mesatare 6 sipas përcaktimit të mësipërm.

Kreu I

Procesi i Aplikimit dhe Pranimeve në nivel kombëtar

Në nivel kombëtar, gjatë vitit akademik 2017-2018, u ofruan:

- **454** programe studimi, nga të cilat:
 - **294** nga IAL-të publike
 - **160** nga IAL-të jopublike.

Programe të studimit dyvjeçare me karakter profesional u ofruan gjithsej **25** të tilla nga të cilat:

- **13** nga IAL-të publike;
- **12** nga IAL-të jopublike.

Për programet e studimit të ciklit të parë, ato 2 vjeçar me karakter profesional dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë për kategorinë shqiptarë brenda vendit, për këtë vit akademik, në tërësi u ofruan:

- **32565** kuota nga të cilat:
 - **22924** kuota nga IAL-të publike;
 - **9641** kuota nga IAL-të jopublike.

Në programet e studimit të ofruara për vitin akademik 2017-2018 **aplikuan** gjithsej në të dy raundet:

- **28845** aplikantë, prej të cilëve u regjistruan në të gjitha IAL-të publike dhe jopublike për kategorinë shqiptarë brenda vendit, **22418** studentë (**18364** studentë në IAL-të publike dhe **4054** në IAL-të jopublike).
- Në total kemi **77.72% studentë të regjistruar** kundrejt aplikantëve në të dyja raundet.

Kreu II

Regjistrimet në nivel sistemi shkollimi (IAL publike/jopublike).


Regjistrimet në IAL-të publike dhe jopublike, krahasuar me regjistrimet në total, pasqyrojnë një shpërndarje në përqindje, të paraqitur në **grafikun 1** të mëposhtëm.

IAL-të publike zënë pjesën më të madhe të regjistrimeve **me**:

- **81.92 %** të tyre.

Pjesa më e madhe e regjistrimeve të studentëve vazhdon të jetë e orientuar drejt IAL-ve publike.

Grafik 1. – Regjistrime në nivel sistem shkollimi (publik/jopublik)



Kreu III

Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL-je

Tabela 1 tregon se sa studentë u regjistruan në çdo Institucion të Arsimit të Lartë, e shprehur kjo në përqindje ndaj totalit të regjistrimeve në nivel kombëtar për vitin akademik 2017-2018.

Tabela 1 – Regjistrime në nivel IAL


IAL	Shpërndarja e regjistrimeve në rang IAL
Universiteti i Tiranës	24.46%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	4.02%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	7.37%
Universiteti Politeknik i Tiranës	7.80%
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	3.22%
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	8.31%
Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë	1.13%
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	6.29%
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	5.31%
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	11.69%
Universiteti i Arteve	1.00%
Universiteti i Sporteve të Tiranës	1.31%
Universiteti "EPOKA"	1.78%
Universiteti "Aldent"	1.77%
Akademia Profesionale e Biznesit	0.25%
Kolegji Universitar "Bedër"	0.38%
Kolegji Universitar "LOGOS"	0.16%
Kolegji Universitar "Luarasi"	0.58%
Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi"	0.01%
Shkolla e lartë universitare, jopublike, "Universiteti "Marin Barleti""	1.04%
Shkolla private e arsimit të lartë, "Universiteti Metropolitan Tirana"	0.45%
Shkolla e Lartë "Nehemia"	0.01%
Universiteti Polis	1.00%
Kolegji Universitar "REALD"	0.15%
Tirana Business University College	0.39%
Kolegji Universitar "WISDOM"	0.10%
Kolegji Profesional Privat, "Ivoclar Vivadent & Partners"	0.08%
Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"	0.57%
Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë"	0.10%
Universiteti Privat "Albanian University"	2.05%
Kolegji Profesional i Tiranës	1.28%

IAL	Shpërndarja e regjistrimeve në rang IAL
Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"	0.95%
Universiteti i New York-ut në Tiranë	0.41%
Universiteti European i Tiranës	2.78%
Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"	1.76%
Kolegji Universitar "Qiriazi"	0.04%

Nga tabela rezulton se, numri më i madh i studentëve të regjistruar, i përket:

- **Universitetit të Tiranës** me **24.46%**, i cili gjithashtu ofron numrin më të madh të kuotave 5631 në 36 programe studimi.
- **Universiteti i Durrësit** me **11.69 %** të studentëve të regjistruar, i cili vjen i treti në listë për nga numri i kuotave të ofruara 2762 të tilla në 44 programe studimi.

Grafik 2 - Regjistrimet sipas Institucioneve të Arsimit të Lartë



Kreu IV

Regjistrimet kundrejt kuotave

Nga totali i kuotave, janë plotësuar me regjistrime 68.84 %, për vitin akademik 2017-2018.

Pra: oferta në kuota përkundrejt aplikantëve është 12.89 % më e lartë.


Çdo aplikanti i është dhënë mundësia të ndjekë një program studimi nisur nga oferta në kuota.

I shprehur në përqindje, raporti ofertë - konsum i kuotave përkatësisht të IAL-ve publike dhe jopublike paraqitet në grafikun 3.

Rezulton se, janë plotësuar me regjistrime në:

- IAL-të publike **80.11 %** e kuotave,
- IAL-të jopublike **42.05 %** e kuotave.

Grafik 3: Kuota të plotësuara me student të regjistruar në nivel sistemi institucionesh publike/jopublike.



Nisur nga përqindja më e lartë e konsumit të kuotave në IAL-të publike shohim se pjesa më e madhe e studentëve preferojnë të regjistrohen në këto IAL.

Plotësimi i kuotave me regjistrime për çdo Institucion të Arsimit të Lartë

Përpunimi i të dhënave, që tregon plotësimin e kuotave me studentë të regjistruar për çdo IAL paraqitet në tabelën e mëposhtme (Tabela 2).

Përqindjen më të lartë të plotësimit të kuotave të ofruara e zë:


- **Universiteti i Sporteve të Tiranës**, i cili ka edhe specifikën e zhvillimi të konkurseve të pranimit, sipas disiplinave, ku aplikantët paraqesin aftësi nga ana përgatitjes sportive.
- Universiteti Politeknik i Tiranës me 99.04 % të kuotave të plotësuara.
- Universiteti i Mjekësisë me 98.80 % të kuotave të plotësuara;
- Universiteti i Tiranës me 97.39 % të kuotave të plotësuara.

Tabela 2 - Plotësimi i kuotave në nivel IAL-je.

Nr.	IAL	Kuota të plotësuar në nivel IAL-je
1	Universiteti i Tiranës	97.39%
2	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	98.80%
3	Universiteti Bujqësor i Tiranës	84.08%
4	Universiteti Politeknik i Tiranës	99.04%
5	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	57.13%
6	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	60.25%
7	Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë	34.32%
8	Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	66.59%
9	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	55.60%
10	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	94.86%
11	Universiteti i Arteve	93.72%
12	Universiteti i Sporteve të Tiranës	100.00%
13	Universiteti "EPOKA"	56.52%
14	Universiteti "Aldent"	58.81%
15	Akademia Profesionale e Biznesit	20.00%
16	Kolegji Universitar "Bedër"	29.66%
17	Kolegji Universitar "LOGOS"	15.98%
18	Kolegji Universitar "Luarasi"	35.83%
19	Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi"	5.00%
20	Shkolla e lartë universitare, jopublike, "Universiteti "Marin Barleti""	69.64%
21	Shkolla private e arsimit të lartë, "Universiteti Metropolitan Tirana"	22.94%
22	Shkolla e Lartë "Nehemia"	15.38%
23	Universiteti Polis	60.54%
24	Kolegji Universitar "REALD"	14.41%
25	Tirana Business University College	80.00%

Nr.	IAL	Kuota të plotësuar në nivel IAL-je
26	Kolegji Universitar "WISDOM"	15.17%
27	Kolegji Profesional Privat, "Ivoclar Vivadent & Partners"	73.08%
28	Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"	51.42%
29	Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë"	8.98%
30	Universiteti Privat "Albanian University"	26.87%
31	Kolegji Profesional i Tiranës	38.87%
32	Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"	41.98%
33	Universiteti i New York-ut në Tiranë	50.28%
34	Universiteti European i Tiranës	71.97%
35	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"	70.48%
36	Kolegji Universitar "Qiriazi"	2.87%

Grafiku 4 - Kuotat e plotësuara sipas Institucioneve të Arsimit të Lartë.



Kreu V

Raporti kuota – kërkesa nga aplikantët në nivel IAL

Një qasje tjetër, në lidhje me kuotat e ofruara në nivel IAL-je, është edhe raporti midis kuotave të vendosura në dispozicion nga IAL-të krahasuar me kërkesat nga ana e aplikantëve.

Maturantët dhe kandidatët kishin të drejtë të përzgjedhin deri në dhjetë programe të ndryshme studimi në raundin e parë dhe/ose të dytë të aplikimeve.

Aplikantët, të cilët nuk u regjistruan në raundin e parë, patën të drejtë riaplikimi, ku mund të përzgjidhnin të njëjtat programe studimi apo programe të tjera.

Kështu, për të përcaktuar numrin e aplikantëve për çdo IAL, është përlogaritur numri i tyre në të dy raundet e marra së bashku. Pra, është përlogaritur çdo aplikant, i cili ka kërkuar të paktën në njërin nga preferencat IAL-në përkatëse, pavarësisht nga raundi.

Ndërkohë, për kuotat, kanë shërbyer si referencë ato të miratuara për kategorinë “Shqiptarë brenda vendit”.

Tabela 3 – Raporti kuota – aplikantë në % për çdo IAL.

IAL	Raporti Kuota -Aplikantë në nivel IAL-je (tregon sa % të kërkesave të aplikantëve plotëson sasia e kuotave të vendosura në dispozicion nga IAL-të)
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	13.54%
Universiteti Politeknik i Tiranës	18.29%
Universiteti i Sporteve të Tiranës	20.55%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	23.72%
Universiteti i Arteve	26.79%
Universiteti i Tiranës	28.18%
Universiteti i New York-ut në Tiranë	31.05%
Tirana Business University College	31.70%
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	32.53%
Kolegji Profesional i Tiranës	34.26%
Universiteti Polis	34.55%
Universiteti European i Tiranës	39.68%
Shkolla e lartë universitare, jopublike, "Universiteti "Marin Barleti""	44.15%
Universiteti "EPOKA"	47.99%
Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"	50.18%
Universiteti "Aldent"	58.24%
Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"	60.69%

IAL	Raporti Kuota -Aplikantë në nivel IAL-je (tregon sa % të kërkesave të aplikantëve plotëson sasia e kuotave të vendosura në dispozicion nga IAL-të)
Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"	65.84%
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	66.39%
Kolegji Universitar "Luarasi"	67.67%
Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi"	85.11%
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	94.42%
Kolegji Profesional Privat, "Ivoclar Vivadent & Partners"	100.00%
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	100.42%
Universiteti Privat "Albanian University"	103.07%
Kolegji Universitar "LOGOS"	107.35%
Shkolla e Larte "Nehemia"	108.33%
Kolegji Universitar "Bedër"	110.27%
Kolegji Universitar "REALD"	111.17%
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	122.64%
Shkolla private e arsimit të lartë, "Universiteti Metropolitan Tirana"	130.93%
Akademia Profesionale e Biznesit	137.25%
Kolegji Universitar "WISDOM"	145.00%
Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë	165.92%
Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë"	176.26%
Kolegji Universitar "Qiriazi"	392.13%

Tabela paraqet sa përqind të kërkesave janë realizuar nga kuotat e e vendosura në dispozicion.

P.sh. Universiteti i Mjekësisë, nisur nga numri i kuotave që ka në dispozicion për pranimet, ka realizuar vetëm 13.54 % të kërkesave nga ana e aplikantëve.

Kjo përqindje e ulët, pra një numër më të lartë aplikantësh për kuotë, erdhi si pasojë e kriterit të pranimi që aplikantët për programet e tij të studimit duhet të plotësonin: nota mesatare 8 dhe/ose 8.5 në ndryshim nga IAL-të e tjera që kishin si kriter notën 6.

Si përfundim:


- Sa më e ulët përqindja aq më i lartë numri i aplikantëve në raport me kuotat. Ky mund të jetë një tregues, i cili ndihmon IAL-të që kanë një sasi të vogël kuotash dhe numër të lartë kërkesash të hartojnë politika të tilla që të përthithin numër më të lartë studentësh, duke zgjeruar kapacitetet e tyre pritëse, si edhe IAL-të që kanë kapacitete te mjaftueshme pritëse, por numër të vogël kërkesash të hartojnë politika që të tërheqin një numër më të lartë aplikantësh.

Grafiku 5 tregon sa përqind të kërkesave, plotësohen nga kuotat e vendosura në dispozicion.

Sigurisht numri i kuotave të paplotësuara në rang IAL tregon se jo të gjitha programet kanë qënë të kërkuara sa të mos mbetej asnjë kuotë e paplotësuar. Siç e përmendëm edhe më lart, aplikantët kishin të drejtë të zgjidhin dhjetë programe studimi, në të cilat mund të regjistroheshin dhe si rrjedhojë, nëse fitonin të dhjetë programet e studimit, mund të regjistroheshin vetëm në njërin prej tyre, duke lënë të lira nëntë programet e tjera.

82% e aplikantëve, me nota mesatare sipas VKM-së, që variojnë nga 9.5 në 10, kanë aplikuar në dhjetë preferenca.

Grafik 5 – Raporti kuota –aplikantë



Kreu VI

Procesi i aplikimeve dhe regjistrimeve në nivel program studimi

Njëzet programet e studimit më të kërkuara në të dyja raundet e aplikimit janë paraqitur në formë tabelare si në tabelën 4.

Tabela 4- Njëzet programet e studimit më të kërkuara

IAL	Program Studimi	Kuota Shqiptarë brenda vendit 17-18	Kërkesa në dy raundet e aplikimit	Raporti Kuota - Aplikantë në programet më të kërkuara
Universiteti i Tiranës	Administrim - Biznes	460	8734	5.27%
Universiteti i Tiranës	Drejtësi	750	8319	9.02%
Universiteti i Tiranës	Punë sociale	100	8012	1.25%
Universiteti i Tiranës	Psikologji	110	7419	1.48%
Universiteti i Tiranës	Shkenca Politike	100	7209	1.39%
Universiteti i Tiranës	Gjuhë Angleze	240	6762	3.55%
Universiteti i Tiranës	Financë	460	6310	7.29%
Universiteti i Tiranës	Gazetari	120	5670	2.12%
Universiteti i Tiranës	Administrim dhe Politika Sociale	100	5531	1.81%
Universiteti i Tiranës	Ekonomiks	110	5170	2.13%
Universiteti i Tiranës	Sociologji	81	4742	1.71%
Universiteti i Tiranës	Informatikë Ekonomike	250	4657	5.37%
Universiteti i Tiranës	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	100	4115	2.43%
Universiteti i Tiranës	Gjuhë- Letërsi	180	3807	4.73%
Universiteti i Tiranës	Informatikë	200	3641	5.49%
Universiteti Politeknik i Tiranës	Inxhinieri Telekomunikacioni	100	3358	2.98%
Universiteti Politeknik i Tiranës	Inxhinieri Informatike	100	3052	3.28%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	Finance-kontabilitet	120	2853	4.21%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Mjekësi e Përgjithshme	270	2819	9.58%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Stomatologji	100	2780	3.60%

Kollona, që paraqet në përqindje raportin kuota- aplikantë në programet më të kërkuara tregon, se sa përqind plotësohen nga kuotat e ofruara për programin e studimit kërkesat e aplikantëve të bërë për programet përkatëse të studimit.


Për programin e studimit Administrim – Biznes në Universitetin e Tiranës raporti është afërsisht 18 kërkesa për kuotë.

Raportin më të lartë kërkesa për kuotë e ka programi i studimit Punë Sociale i Universitetit të Tiranës, me afërsisht 80 kërkesa për kuotë.

Përsa i përket plotësimit të kuotave me të regjistruar për program studimi vërejmë se:

- nga 454 programe studimi të ofruara në vetëm 129 prej tyre numri i kuotave përputhet me numrin e të regjistruarve, e shprehur në përqindje 28.41 %.
- Pjesën më të madhe të programeve të plotësuara me regjistrime e zënë ato të IAL-ve publike me 122 programe, të cilat kanë plotësuar kapacitetet e tyre pritëse për program studimi.

Grafik 6 - Kuota të plotësuara me regjistrime sipas programeve të studimit



Bazuar në të dhënat e përpunuara për realizimin e kuotave për çdo program studimi rezulton se:

- 28.41% e programeve të studimit janë plotësuar me regjistrime;
- 71.59% e tyre kanë kuota të paplotësuara.

Kreu VII

Regjistrimet sipas gjinisë dhe urbanizimit

Tabela 7 paraqet regjistrimet në nivel kombëtar, sipas urbanizimit fshat/qytet, sipas gjinisë femra/meshkuj, sipas sistemit publik/jopublik.

Tabela 7

	Studentë të regjistruar total	Në %	Studentë të regjistruar IAL Publike	Në %	Studentë të regjistruar IAL Jopublike	Në %
Femra	14046	62.66%	12216	66.52%	1830	45.14%
Meshkuj	8372	37.34%	6148	33.48%	2224	54.86%
Qytet	18256	81.43%	14561	79.29%	3695	91.14%
Fshat	4162	18.57%	3803	20.71%	359	8.86%

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se për vitin akademik 2017-2018, në nivel kombëtar:

- ka më shumë studente femra.
- pjesa më e madhe e të regjistruarve janë nga zonat urbane.

Për IAL-të publike:

- numri më i madh i të regjistruarve, 66.52%, janë femra.
- sipas urbanizimit, 79.29% e të regjistruarve në IAL-të publike vijnë nga qytetet.


Për IAL-të jopublike rezulton se:

- numri më i madh i të regjistruarve, 54.86%, janë meshkuj (në ndryshim nga publiku);


- sipas urbanizimit, pjesa më e madhe e të regjistruarve janë nga qyteti.

Grafikisht shpërndarja e regjistrimeve sipas gjinisë paraqitet si në grafikët 8 dhe 9.

Grafik 8 –Regjistrime (F/M) nivel kombëtar




Grafik 9- Regjistrime femra/meshkuj sipas sistemeve IAL publike/jopublike




Paraqitja grafike e regjistrimeve sipas Urbanizimit paraqitet ne grafikët 9 dhe 10.

Grafik 9- Regjistrime(Q/F) nivel kombëtar



Grafik 10- Regjistrime Qytet/Fshat sipas sistemeve IAL publike/jopublike



Kreu VIII

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL

Për të analizuar cilësinë e studentëve të regjistruar në ciklin e parë, dhe siç është përmendur, një rol të rëndësishëm kanë luajtur rezultatet e arritura nga kandidatët për student në ciklin e arsimit parauniversitar, është përdorur si tregues nota mesatare, e llogaritur sipas VKM 346, datë 19.04.2017

Kështu në nivel kombëtar kemi:

- Nota mesatare e të gjithë të regjistruarve **7.76**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të publike **7.82**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të jopublike **7.52**.

Në nivel kombëtar, studentët e regjistruar në IAL-të publike kanë mesatare më të lartë se studentët e regjistruar në IAL-të jopublike.


Nga të dhënat e përpunuara rezulton se:

- notën mesatare më të lartë e ka Universiteti i Mjekësisë: 9.39;
- notën mesatare më të ulët e ka Kolegji universitar “Qiriazi: 6.65;
- Kolegji Profesional i Tiranës ka një mesatre note: 5.89. Por ky kolegji ofron vetëm programe dyvjeçare dhe si rrjedhojë aty regjistrohen kryesisht studentë me notë mesatare më të vogël se 6.

Tabela 8 – Nota mesatare e studentëve të regjistruar për çdo IAL

IAL	Numri i studentëve të regjistruar për çdo IAL	Mesatarja sipas VKM për çdo IAL
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	902	9.39
Universiteti "EPOKA"	399	8.79
Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"	212	8.57
Universiteti Politeknik i Tiranës	1748	8.53
Shkolla e Larte "Nehemia"	2	8.50
Universiteti i New York-ut në Tiranë	91	8.48
Universiteti i Tiranës	5484	8.39
Tirana Business University College	88	8.11
Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"	127	8.03
Universiteti "Aldent"	397	7.75
Universiteti European i Tiranës	624	7.65
Kolegji Universitar "Luarasi"	129	7.63
Kolegji Universitar "Bedër"	86	7.54
Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi"	2	7.52
Universiteti i Arteve	224	7.49
Universiteti Bujqësor i Tiranës	1653	7.37
Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë"	22	7.37
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	1409	7.34
Shkolla private e arsimit të lartë, "Universiteti Metropolitan Tirana"	100	7.29
Universiteti Polis	224	7.25
Kolegji Profesional Privat, "Ivoclar Vivadent & Partners"	19	7.24
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	1191	7.23
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	2620	7.23
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	721	7.21
Universiteti i Sporteve të Tiranës	294	7.20
Universiteti Privat "Albanian University"	460	7.20
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	1864	7.17
Kolegji Universitar "LOGOS"	35	7.13
Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"	394	7.07
Kolegji Universitar "WISDOM"	22	6.98
Akademia Profesionale e Biznesit	56	6.94
Shkolla e lartë universitare, jopublike, "Universiteti "Marin Barleti""	234	6.91
Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë	254	6.90
Kolegji Universitar "REALD"	33	6.85
Kolegji Universitar "Qiriazi"	10	6.65
Kolegji Profesional i Tiranës	288	5.89

Grafik 11. – Notat mesatare të studentëve të regjistruar në nivel IAL



Studentët më cilësorë në hyrje janë regjistruar në Universitetin e Mjekësisë.

Tabela 9 paraqet njëzet e pesë programet e studimi, të cilat kanë studentëve të regjistruar me notën mesatare më të lartë.

Programet e studimit janë paraqitur të renditura sipas notës mesatare në rendin zbritës

Tabela 9 – Programet e studimit me mesatare më të lartë

IAL	Program Studimi	Numri i studentëve të regjistruar	Nota Mesatare VKM nivel program studimi
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Mjekësi e Përgjithshme	270	9.75
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Stomatologji	100	9.60
Universiteti Politeknik i Tiranës	Inxhinieri Informatike	100	9.57
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Farmaci	100	9.48
Universiteti Politeknik i Tiranës	Inxhinieri Elektronike	100	9.41
Universiteti i Tiranës	Informatikë Ekonomike	250	9.41
Universiteti Politeknik i Tiranës	Arkitekturë (Arkitekt)	107	9.36
Universiteti Politeknik i Tiranës	Inxhinieri Telekomunikacioni	100	9.31
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Logopedi	20	9.28
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Fizioterapi	40	9.25
Universiteti i New York-ut në Tiranë	“Administrim Biznesi” me profil “Kontabilitet”	3	9.24
Universiteti i Tiranës	Financë	460	9.24
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Imazheri	43	9.22
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Teknikë e Lartë Laboratorike	38	9.14
Universiteti Politeknik i Tiranës	Inxhinieri Ndërtimi	100	9.13
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Infermieri e Përgjithshme	239	9.09
Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"	Mjekësi	102	9.08
Universiteti i Tiranës	Informatikë	200	9.08
Universiteti Politeknik i Tiranës	Arkitekturë (Urbanist)	55	9.07
Universiteti "EPOKA"	Inxhinieri Kompjuterike	60	8.98
Universiteti Politeknik i Tiranës	Arkitekturë Interieri dhe Dizajn	30	8.98
Universiteti "EPOKA"	Arkitekturë	45	8.94
Universiteti "EPOKA"	Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital	31	8.92
Universiteti "EPOKA"	Ekonomiks	29	8.91
Universiteti "EPOKA"	Inxhinieri Ndërtimi	31	8.91

